

*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.12.04.2021*

**12.04.2021
Ora 13:35**

RENDI I DITËS

Projektvendim “Për shqyrtimin e raportit të Autoritetit të Medias Audiovizive të Pasqyrimit të fushatës zgjedhore nga OSHMA-të për periudhën 26.03.2021-03.04.2021”.

PJESËMARRJA :

• **KQZ**

1.Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve Z.Illirjan Celibashi

2.Stafi KQZ: Y.Merkaj, M.Koja, E.Allushi, V.Ballgjini

• **Parti Politike: PD, LSI**

Z. I. Celibashi: Vazhdojmë me pikën e dytë të rendit të ditës që ka të bëjë me shqyrtimin e raportit të Autoritetit të Medias Audiovizive të Pasqyrimit të fushatës zgjedhore nga OSHMA-të për periudhën 26.03.2021-03.04.2021.

Z. Y. Merkaj: Neni 78, pika “3” e Kodit Zgjedhor parashikon se rregullat, kushtet dhe kufizimet e përcaktuara në këtë ligj kanë qëllim garantimin e barazisë së subjekteve zgjedhore në garë sigurimin e pa anësisë së operatorëve radiotelevizive në raport me fushatën e subjekteve zgjedhore si dhe mbrojtjen e subjekteve zgjedhore nga praktikat e deformimit të mesazhit zgjedhor. Neni 80, 81 i Kodit Zgjedhor, parashikon rregullat e pasqyrimit të fushatës zgjedhore, të subjekteve zgjedhore dhe edicionet informative në radiotelevizionin publik. Neni 83 i Kodit Zgjedhor, parashikon se jo më vonë se 30 ditë para datës së zgjedhjeve Këshilli Drejtues i Radiotelevizionit Publik cakton minutazh në dispozicion të çdo partie në

Zbardhi materialin audio

Silvi SINO



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.12.04.2021*

bazë të të dhënave të paraqitura nga KQZ-ja për partitë e regjistruara. Në bazë të nenit 84, të Kodit Zgjedhor, parashikohet se fushata zgjedhore në radiotelevizione private, përcaktohen qartë rregullat e pasqyrimit të fushatës, minutazhit politik dhe transmetimit të veprimtarive të institucioneve publike qendrore ose vendore. Pasqyrimin e veprimtarive të partive parlamentare, marrëdhënien me KQZ-në si dhe kompetencën e KQZ-së për të urdhëruar Entin Rregullator për të proceduar me bllokimin e transmetimeve në çdo rast shkeljeje. Neni 85 i Kodit Zgjedhor shprehet se për monitorimin e fushatës zgjedhore në media, i cili kryhet nga një Ent Rregullator në këtë rast është autoriteti i medias audiovizive. Në raportin e dorëzuar pranë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve me vendimin nr.51 datë 06.04.2021, AMA ka shqyrtuar raportet për periudhën 26.03.2021-03.04.2021 dhe vlen jo vetëm si raport i monitoruesit, por dhe propozimet përkatëse për marrjen e masave administrative. Raporti përmbledhës përmban të dhëna mbi depozitimin në AMA të përmbajtjeve të transmetuara nga ofertuesi i shërbimeve të mediave audiovizive. Kohën e monitorimit, kohën e monitorimit për transmetimet live në hapësirë për çdo aktor politik, si dhe reklamat politike dhe raportin gjinor të mbulimit mediatik të kandidatëve. Në lidhje me treguesin e depozitimit të regjistrimit në AMA, parashikohet se kjo pasqyrohet në metodologjinë e monitorimit të mediave audio dhe audiovizive. Detyrimi për depozitimin e trasmetimeve është çdo ditë, ndërsa për OSHMA-të vendore që nuk mbulohen nga mjetet monitoruese ky detyrim bëhet transmetimi në ditën pasardhëse të monitorimit. Në bazë të nenit 51 të AMA-së rezulton se 13 subjekte audiovizive nuk kanë respektuar detyrimin ligjor të përcaktuar më lart pasi nuk kanë depozituar regjistrimin për periudhën 26.03.2021-03.04.2021. AMA i propozon KQZ-së që këto OSHMA të procedojnë me marrjen e masave administrative të parashikuara sipas Kodit Zgjedhor. Gjithashtu AMA informon Komisionin Qendror të

*Zbardhi materialin audio
Silvi SINO*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.12.04.2021*

Zgjedhjeve se 15 ofrues të shërbimeve mediatike dhe audiovizive kanë depozituar regjistrime jo për të gjitha ditët të kësaj periudhe. Për këtë AMA i propozon KQZ-së t'u tërheqë vëmendjen OSHMA-ve për respektimin e plotë të këtij detyrimi. Në lidhje me treguesit monitorimi i edicioneve informative ku parashikohet se minutazhi politik të edicioneve informative radio television public është i detyruar të zbatojë raportet kohore të barabarta për të gjithë partitë parlamentare. Ky detyrim vlen edhe për subjektet audiovizive private. Në tabelën nr.1 që është pjesë e këtij vendimi pasqyrohet koha e plotë e subjekteve politike PD, PS, LSI, PSD dhe PDIU. Nga edicionet informative referuar të dhënat e tabelës vërehet se minutazhi politik në edicionet informative, ka shpërndarje të pabarabartë dhe jo në përputhje me nenin 81 të Kodit Zgjedhor. Si rrjedhojë AMA i propozon KQZ që 31 OSHMA-të të listuara në tabelën nr.1 të bëjnë kompesimin për kohën e transmetimit të lajmeve për balancim. Referuar nenit 65, pika 3 e Kodit Zgjedhor partitë politike që janë pjestarë të një koalicioni të drejtat dhe detyrimet e tyre përmbushen nga partia udhëheqëse e koalicionit. Në këtë kuptim të kësaj dispozite PDIU, garon për zgjedhjet për Kuvend të datës 25 prill 2021 si pjesë e Koalicionit Partia Demokratike Aleanca për Ndryshim. Në zbatim të dispozitës së mësipërme Komisioneri vendosi të përjashtojë PDIU-në nga projektfitimi i kompesimit në kohë transmetimi dhe të edicionit të lajmeve për balancim. Gjithashtu në lidhje me treguesit AMA ka identifikuar dhe raportuar për informacione ditore në KQZ të subjektit TV Bulqiza.

*Zbardhi materialin audio
Silvi SINO*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.12.04.2021*

Z. Y. Merkaj: E cila ka përfshirë në përmbajtjen e saj audiovizive ritransmetimin e edicionit informativ të një OSHMA-je tjetër nga data 28, 29, 30,1, 2 dhe 3 Prill. AMA i propozon KQZ-së për ndërprerjen e menjëhershme të transmetimit për përmbajtjen informative të OSHMA-së tjetër. Për treguesin, transmetimin e klaneve politike në zbatim të nenit 84, pika 4 të Kodit Zgjedhor. AMA rezulton se 10 vëzhgues OSHMA nuk e kanë respektuar këtë kërkesë të Kodit Zgjedhor dhe i propozojnë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve ndërprerjen e transmetimit të kaheve politike jashtë intervaleve kohore të përcaktuar nga Kodi Zgjedhor. Gjithashtu AMA ka konstatuar raste të transmetimit të reklameve politike brenda edicioneve të lajmeve nga OSHMA, Klan News, Alpo, Rea.al. Sa i takon vlerësimin gjinor të përmbajtjeve të transmetuara nga OSHMA-të për fushatën elektorale, përveç operatorëve RTSH1, Shijak TV, Apollon, Rozafa, MCN dhe Adria. Net, të cilët kanë pasur përfaqësim të balancuar, pjesa tjetër ka disbalancë për këtë tregues. OSHMA-të kombëtare dhe lokale që mbulojnë më shumë se 48% të popullsisë rezulton se nuk kanë respektuar raportin e përfaqësimit ligjor për pasqyrimin e fushatës zgjedhore. Për këtë AMA i propozon KQZ-së, ti tërheqë vëmendjen OSHMA-ve të jenë më të ndjeshëm dhe të vëmendshëm në respektimin e këtij kriteri. Nisur nga monitorimi i respektimit të kërkesave të nenit 78 të Kodit Zgjedhor, nuk është identifikuar ndonjë rast ku janë shkelur kërkesat e këtij Kodi. Pas verifikimeve përkatëse dhe dokumentacionit në tërësi, në lidhje me shqyrtimin e raportit të AMA-së “Për mbulimin e fushatës zgjedhore nga OSHMA-të”, konstatoj se dokumentacioni i paraqitur është në përputhje me përcaktimet e neneve 19,78,80,81,83,84 dhe 85 të Kodit Zgjedhor. Në mbështetje të neneve të mësipërme, i propozojmë Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve miratimin e masave administrative kundrejt OSHMA-ve të raportuara nga Autoriteti i Mediave Audiovizive.

*Zbardhi materialin audio
Valbona DUSHI*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.12.04.2021*

Z. I. Celibashi: Faleminderit, përfaqësuesit e partive politike?

Z. L. Nuraj, përfaqësues i PD-së: Po i nderuar pasi kemi parë dhe njohur me raportin e AMA-së, i cili ka ardhur te ju. Ne nuk kemi parë dhe nuk e dimë sesa janë matjet ditore në raportin që ka ardhur dhe matjet javore pasi për ne mendojmë që janë disa matje të përgjithshme dhe rezultatet që kanë dalë janë mbi matje të përgjithshme. Nuk kemi parë të dhënat mbi transmetimet live të pasqyruara nga AMA dhe duke kontrolluar këto televizione, pasi dhe këtu duhet të ishin reflektuar dhe të kishin një pasqyrë të qartë. Masat që kanë kërkuar për kompensim nuk kanë afate konkrete dhe gjatë kësaj kohe ne mendojmë që duke mos pasur afate konkrete mund të thellohet përsëri diferenca e minutazheve në disfavor të forcës politike Partisë Demokratike apo dhe forcave të tjera kundrejt Partisë Socialiste. Pasi duket shumë qartë në të gjitha tabelat që Partia Socialiste, në të gjitha televizionet i ka kaluar minutazhet e lejuara apo të kërkuara dhe koha e mbetur për rikuperim mund të jetë e pamjaftueshme nëse nuk jepen afatet më të shkurtuara për subjektet që e kanë tejkaluar dhe të kemi një kompensim të drejtë në lidhje me afatet në lidhje me subjektet e tjera. Mesa shoh në të tërë raportin që kemi pasur në dispozicion nga AMA, i cili ka ardhur këtu, është përqëndruar në masa apo në qortime konkrete më shumë nëpër televizione lokale dhe televizionesh rrethesh, ku ndërkohë pesha specifike e audiencës është televizionet kombëtare dhe 3, 4 apo 5 televizione që operojnë në Tiranë. Kur shikohet që dhe në këto televizione kemi një diferencë dhe një thellim minutazhi në disfavor të forcës politike PD. Edhe aty kërkohet kompensim dhe në të gjithë tabelën që ne kemi në dispozicion nga AMA, shikoj se të gjithë operatorët janë në borxh me Partinë Demokratike në lidhje me kohën televizive. Mendohet se këto të dhëna do të ishin përcjellë më të detajuar dhe ne të

*Zbardhi materialin audio
Valbona DUSHI*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.12.04.2021*

kishim për të bërë objeksione edhe ju përkatëse më të thelluara. Nuk kemi parë të reflektuar as balancën e emisioneve kur duhet të ketë nivel ballafaqimi mes forcave politike dhe këtë minutazh ne nuk e kemi përpara dhe nuk arrijmë dot të vlerësojmë sesa jemi në disfavor apo në raport me forcat e tjera si dalim. Kemi parë në raport ku thotë se konstatoj, problematikën e kohës që Partia Socialiste zë në fushatë pothuajse të gjitha televizionet duhet ta kompesojnë Partinë Demokratike pasi i kanë dhënë më shumë kohë Partisë Socialiste, kjo është e thënë qartazi në raport. Por, në raport AMA nuk na sugjeron se çfarë duhet të bëjë Komisioneri vetëm në lidhje me rregullimin por dhe në lidhje me penalizimin e këtyre televizioneve. Pasi kemi televizione siç shikohet pavarësisht se janë lokale por dalin televizione problematike në lidhjen e kohës pasi siç është përshembull REAL TV, që ka kaluar çdo limit vetëm në lidhje me propogandën vetëm për një parti politike siç është Bindja Demokratike. Nuk sugjerohen masa që duhet të marrë Komisioneri, për ne janë masa të buta ato që sugjerohen në lidhje siç parashikohen në pikën 6, të nenit 81, të Kodit Zgjedhor siç janë masat me gjobitjen e këtyre televizioneve. Këtu janë komentet tona pak a shumë të cilat mendoj që duhet të ishin reflektuar edhe në vendim disa prej tyre, faleminderit.

Z. I. Celibashi: Faleminderit, përfaqësues i Lëvizjes Socialiste për Integrim!

Z. A. Kaziaj, përfaqësues i LSI-së: Gjej dakordësi të plotë me kolegun, këtu është një gjë shumë e shëmtuar. Shohim televizionin publik një OSHMA publike e cila jep 100% të kohës së vetë një subjekti politik në këtë rast Partia Socialiste e Shqipërisë duke diferencuar PD, LSI, PSD, PDIU me një minutazh të palogjikshëm duke e lënë të pashfrytëzuar këtë minutazh. Shohim nga materiali i sjellë nga ana juaj që të gjitha televizionet kombëtare shumë të mëdhaja, shumë të

*Zbardhi materialin audio
Valbona DUSHI*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.12.04.2021*

shikuara në Republikën e Shqipërisë, diferencojnë qartazi subjektet e tjera politike duke mos u bindur një detyrimi ligjor të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve. Duke mos u bindur detyrimit ligjor të Kodit Zgjedhor dhe të akteve të dala në zbatim të tij. Kjo gjë është e qëllimshme dhe mesa shoh ka pasur një ushtrim ndikimi nga ana e subjektit qeverisës në këtë rast, se përndryshe kjo nuk ka asnjë lloj logjike qoftë dhe televizionet publike dhe ato jo publike dhe kombëtare jo kombëtare, të japin një minutazh të lënë të papërdorshëm një minutazh të caktuar për subjektet e tjera të opozitës dhe subjekti i pozitës merr gjithçka duke pasur avantazhe jo të ligjshme në këtë rast. Do të donim që ju nëpërmjet këtij akti të vepronit me një saktësim të asaj që është vendimmarrja juaj dhe jo nëpërmjet tërheqjes së vëmendjes, po nëpërmjet sanksionimit. Po ashtu duke rregulluar dhe kohën se kur duhet të shfrytëzohet ky minutazh i pashfrytëzuar në të gjitha këto OSHMA. Pra koha të jetë shumë e shkurtër duke mos i dhënë më kohë subjektit politik, i cili e ka shfrytëzuar atë Partia Socialiste dhe duke i vënë në dispozicion në orare të caktuara sipas vendimit të gjithë minutazhin e pashfrytëzuar në subjektet e tjera, faleminderit.

Z. I. Celibashi: Faleminderit, në lidhje me këto të dhëna, raporte ditore gjenden të publikuara në faqen e internetit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, raportet ditore të AMA-së. Gjithsesi ndoshta për t'ju dhënë kohë dhe për t'i rikonsultuar dhe një herë nga ana juaj ne mund ta shtymë dhe ta lemë për nesër vendimmarrjen në lidhje me këtë pikë të rendit të ditës. Qëndron ai argumenti në lidhje me vendosjen e një afati brenda të cilës ato kompesimet do të duhen të bëhen dhe do ta konsiderojmë këtë. Por, për të pasur nga ana juaj një informacion më të plotë dhe për ta konsultuar meqënëse duket që nuk e kemi konsultuar informacionin bazuar

*Zbardhi materialin audio
Valbona DUSHI*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.12.04.2021*

12.04.2021
Ora 13:54

RENDI I DITËS

Projektudhëzimi “Për miratimin e procedurave të dorëzimit të kamerës për video regjistrim në mjedisin e brendshëm të qendrës së votimit”.

PJESËMARRJA :

- **KQZ**
1.Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve **Z.Ilirjan Celibashi**
2.Stafi KQZ: **Y.Merkaj, M.Koja, V.Ballgjini, E.Allushi**
- **Parti Politike: PD, LSI**

Z. I. Celibashi: Vazhdojmë me pikën tjetër të rendit të ditës!

Z. Y. Merkaj: Komisioni Rregullator me vendimin nr. 11, datë 25.03.2021, ka përcaktuar mënyrën e ngritjes, së funksionimit dhe organizimit të KQV-së, si dhe zhvillimin e zgjedhjeve në qendrat e votimit. Në nenin 18, pika 6 të këtij vendimi është përcaktuar procedura për dorëzimin e kamerës për video regjistrimin e mjediseve të brendshme të qendrës së votimit, përcaktohet nga Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve. Gjithashtu neni 19 dhe lidhja nr. 3 e këtij vendimi, përcakton rregullat për përdorimin dhe specifikimin teknik të kamerave regjistruese në qendrat e votimit, për zgjedhjet për Kuvend të datës 25 Prill 2021. Nisur nga këto parashikime të vendimit të Rregullatorit, kemi përgatitur udhëzimin e Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve “Për miratimin e procedurave të dorëzimit të kamerës për video regjistrim në mjedisin e brendshëm të qendrës së votimit”. Gjithashtu është dhe lidhja nr. 1 e cila parashikon të gjitha procedurat e dorëzimit të kamerës video

**Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU**



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.12.04.2021*

regjistruese në mjediset e brendshme të qendrës së votimit. Bashkëlidhur keni projektudhëzimin si dhe lidhjen nr.1, faleminderit!

Z. I. Celibashi: Përfaqësuesit e partive politike? Nuk keni?!

Atëherë, miratohet dhe projektudhëzimi “Për miratimin e procedurave të dorëzimit të kamerës për video regjistrim në mjedisin e brendshëm të qendrës së votimit”, sipas draftit të propozuar.

Udhëzimi nr.7

**Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU**



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.12.04.2021*

**12.04.2021
Ora 13:51**

RENDI I DITËS

Projektvendimi “Për plotësimin e vakancës në Këshillin e Bashkisë Lezhë, me kandidatin nga lista shumemërore e Partisë Socialiste të Shqipërisë, zonja Donika Pal Ndreu”.


PJESËMARRJA :

- **KQZ**
 1. Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve **Z. Ilirjan Celibashi**
 2. Staf i KQZ: **Y. Merkaj, M. Koja, V. Ballgjini, E. Allushi**
- **Parti Politike: PD, LSI**

Z. I. Celibashi: Vazhdojmë me pikat e tjera të rendit të ditës! Me aktin “Për plotësimin e vakancës në Këshillin e Bashkisë Lezhë”.

Z. Y. Merkaj: Këshilli i Bashkisë Lezhë, ka njoftuar Komisionin Qendror të Zgjedhjeve për krijimin e vakancës nga këshilltari, z. Frrok Ndue Pjetri, propozuar nga Partia Socialiste e Shqipërisë. Referuar nenit 164, pika 2 Kodit Zgjedhor, kandidati vijues nga lista shumemërore e Partisë Socialiste e Shqipërisë, për Këshillin e Bashkisë Lezhë, të cilit i kalon mandati i këshilltarit, është kandidati me numër rendor 18, zonja Donika Pal Ndreu. Kandidati për këshilltar, ka plotësuar e depozituar formularin e vetëdeklarimit, me numër unik 2146. Nga verifikimi i formularit të vetëdeklarimit, rezulton se nuk ka deklaruar asnjë të dhënë që ka të bëjë me parashikimet për ndalime në Ligjin nr. 138/2015. Komisioni Qendror i Zgjedhjeve ka kërkuar informacion nga zyra e gjendjes civile dhe ajo e gjendjes

**Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU**



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.12.04.2021*

gjqësore. Në përgjigje të shkresës së Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Gjyqësore ka dërguar verifikimin e gjendjes gjyqësore për kandidatin për anëtar në Këshillin e Bashkisë Lezhë, e cila rezulton se nuk ka shënime në sistem. Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile nuk i ka kthyer ende përgjigje kërkesës sonë. Referuar pika 2, të Kreut V, të vendimit nr. 17/2016 të Kuvendit konstatohet se, të dhënat e kandidatit për anëtar zonja Donika Pal Ndreu, në Këshillin e Bashkisë Lezhë, nuk përbëjnë kusht për moszgjedhjen e saj në funksionin e këshilltarit. Bashkangjitur gjeni projektvendimin për miratim si dhe dokumentacionin përkatës, faleminderit!

Z. I. Celibashi: Përfaqësuesit e partive politike? Nuk keni?!

Atëherë, bazuar në nenet 19, pikat 1, shkronja “n” e 2, e vijues të Kodit Zgjedhor, Vendos:

Zj. Donika Pal Ndreu, kandidat për anëtar në Këshillin e Bashkisë Lezhë, nuk përfshihet në kushtet e moszgjedhshmërisë për ushtrimin e funksionit.

2. Plotësimin e vakancës në Këshillin e Bashkisë Lezhë, me kandidatin nga lista shumëmemërore e Partisë Socialiste e Shqipërisë, zj. Donika Pal Ndreu.

3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Komisionin e Ankimimeve dhe Sanksioneve, brenda 3 (tre) ditëve nga hyrja e tij në fuqi.

4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.

Vendimi nr.215

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.12.04.2021*

12.04.2021
Ora 13:51

RENDI I DITËS

Projektvendimi “Për plotësimin e vakancës në Këshillin e Bashkisë Kamëz, me kandidatin nga lista shumemërore e Partisë Socialiste të Shqipërisë, zj. Vjola Spiro Murati”.

PJESËMARRJA :

- **KQZ**
 - 1.Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve **Z.Ilirjan Celibashi**
 - 2.Stafi KQZ: **Y.Merkaj, M.Koja, V.Ballgjini, E.Allushi**
- **Parti Politike: PD, LSI**

Z. I. Celibashi: Vazhdojmë me pikën tjetër të rendit të ditës!

Z. Y. Merkaj: Këshilli i Bashkisë Kamëz, ka njoftuar Komisionin Qendror të Zgjedhjeve për krijimin e vakancës nga këshilltari, zonja Nexhmije Shefit Topi, propozuar nga Partia Socialiste e Shqipërisë. Referuar nenit 164, pika 2 Kodit Zgjedhor, kandidati vijues nga lista shumemërore e Partisë Socialiste e Shqipërisë, për Këshillin e Bashkisë Kamëz, të cilit i kalon mandati i këshilltarit, është kandidati me numër rendor 50, zonja Viola Spiro Murati. Kandidati për këshilltar, ka plotësuar e depozituar formularin e vetëdeklarimit, me numër unik 2144. Nga verifikimi i formularit të vetëdeklarimit kandidatit për anëtar të Këshillit të Bashkisë Kamëz, konstatohet se në të dhënat në rubrikën “të dhëna personale” ka ndryshuar mbiemrin nga Topi në Murati. Komisioni Qendror i Zgjedhjeve ka kërkuar informacion nga zyra e gjendjes civile dhe ajo e gjendjes gjyqësore. Në përgjigje të kërkesës sonë,

**Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU**



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.12.04.2021*

Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Gjqësore ka dërguar verifikimin e gjendjes gjyqësore për kandidatin për anëtar në Këshillin e Bashkisë Kamëz, e cila rezulton se nuk ka shënime në sistem. Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile nuk i ka kthyer ende përgjigje kërkesës sonë. Referuar pika 2, të Kreut V, të vendimit nr. 17/2016 të Kuvendit konstatohet se, të dhënat e kandidatit për anëtar në Këshillin e Bashkisë Kamëz, nuk përbëjnë kusht për moszgjedhjen e saj në funksionin e këshilltarit. Bashkëlidhur keni projektvendimin për shqyrtim dhe miratim, faleminderit!

Z. I. Celibashi: Përfaqësuesit e partive politike? Nuk keni?!

Atëherë, bazuar në nenet 19, pikat 1, shkronja “n” e 2, e vijues të Kodit Zgjedhor, Vendos:

1. Zj. Viola Spiro Murati, kandidat për anëtar në Këshillin e Bashkisë Kamëz, nuk përfshihet në kushtet e moszgjedhshmërisë për ushtrimin e funksionit.
2. Plotësimin e vakancës në Këshillin e Bashkisë Kamëz, me kandidatin nga lista shumemërore e Partisë Socialiste e Shqipërisë, zonja Viola Spiro Murati.
3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Komisionin e Ankimimeve dhe Sanksioneve, brenda 3 (tre) ditëve nga hyrja e tij në fuqi.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.

Vendimi nr.216

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.12.04.2021*

**12.04.2021
Ora 13:56**

RENDI I DITËS

Projektvendimi “Për miratimin e vëzhguesve afatshkurtër të Komitetit Shqiptar të Helsinkit (KSHH) për vëzhgimin e zgjedhjeve për Kuvend, të datës 25 Prill 2021”.

PJESËMARRJA :


- **KQZ**
1.Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve **Z.Ilirjan Celibashi**
2.Stafi KQZ: **Y.Merkaj, M.Koja, V.Ballgjini, E.Allushi**
- **Parti Politike: PD, LSI**

Z. I. Celibashi: Vazhdojmë me pikën tjetër të rendit të ditës!

Z. Y. Merkaj: Komiteti Shqiptar i Helsinkit ka paraqitur kërkesë në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, për akreditimin e 190 vëzhguesve afatshkurtër si dhe zonat e vëzhgimit të tyre. Komiteti Shqiptar i Helsinkit është organizatë joqeveritare e specializuar dhe angazhuar për mbrojtjen e të drejtave të njeriut dhe lirive themelore për formimin e shtetit ligjor dhe monitorimin e zgjedhjeve. Si i tillë gëzon të drejtën për të caktuar vëzhgues për zgjedhjet e datës 25 Prill 2021. Nga shqyrtimi i dokumentacionit konstatojmë se është në përputhje me nenin 6 të Kodit Zgjedhor dhe me Udhëzimin nr. 2/2021 të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve. Bashkëlidhur keni projektvendimin për miratim si dhe listën e vëzhguesve afatshkurtër, faleminderit!

Z. I. Celibashi: Këto janë projektaktet për të gjithë...

**Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU**



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.12.04.2021*

Z. Y. Merkaj: Po i propozojmë një nga një.


Z. I. Celibashi: Jo s'ka nevojë! E keni parë dokumentacionin tek të gjithë kërkuesit dhe është në përputhje me kodin? Nuk ka asnjë problem në lidhje me dokumentacionin nga asnjë prej organizatave?

Z. Y. Merkaj: Jo, jo, janë të gjitha në rregull.

Z. I. Celibashi: Dakord, përfaqësuesit e partive politike? Nuk kanë ndonjë diskutim. Atëhere, miratohet kërkesa e Komitetit Shqiptar të Helsinkit për akreditimin e 190 vëzhguesve afatshkurtër.

Vendimi nr.217

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.12.04.2021*

12.04.2021
Ora 13:56

RENDI I DITËS

Projektvendimi “Për miratimin e vëzhguesve afatshkurtër të “Shoqatës për Kulturë Demokratike” për vëzhgimin e zgjedhjeve për Kuvend, të datës 25 Prill 2021”.

PJESËMARRJA :

- **KQZ**
1.Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve **Z.Illirjan Celibashi**
2.Stafi KQZ: **Y.Merkaj, M.Koja, V.Ballgjini, E.Allushi**
- **Parti Politike: PD, LSI**

Z. I. Celibashi: Vazhdojmë me pikën tjetër të rendit të ditës!


E keni parë dokumentacionin tek të gjithë kërkuesit dhe është në përputhje me kodin? Nuk ka asnjë problem në lidhje me dokumentacionin nga asnjë prej organizatave?

Z. Y. Merkaj: Jo, jo, janë të gjitha në rregull.

Z. I. Celibashi: Dakord, përfaqësuesit e partive politike? Nuk kanë ndonjë diskutim. Atëhere, miratohet kërkesa e “Shoqatës për Kulturë Demokratike” për akreditimin e 78 vëzhguesve afatshkurtër.

Vendimi nr.218

**Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU**



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.12.04.2021*

12.04.2021
Ora 13:56

RENDI I DITËS

Projektvendimi “Për miratimin e vëzhguesve afatgjatë të “Shoqatës Intelektualët e Rinj” për vëzhgimin e zgjedhjeve për Kuvend, të datës 25 Prill 2021”.

PJESËMARRJA :

- **KQZ**
1.Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve **Z.Illirjan Celibashi**
2.Stafi KQZ: **Y.Merkaj, M.Koja, V.Ballgjini, E.Allushi**
- **Parti Politike: PD, LSI**

Z. I. Celibashi: Vazhdojmë me pikën tjetër të rendit të ditës!


E keni parë dokumentacionin tek të gjithë kërkuesit dhe është në përputhje me kodin? Nuk ka asnjë problem në lidhje me dokumentacionin nga asnjë prej organizatave?

Z. Y. Merkaj: Jo, jo, janë të gjitha në rregull.

Z. I. Celibashi: Dakord, përfaqësuesit e partive politike? Nuk kanë ndonjë diskutim. Atëhere, miratohet kërkesa e “Shoqatës Intelektualët e Rinj” për akreditimin e 2 vëzhguesve afatgjatë, sipas lidhjes nr.1 bashkëlidhur këtij vendimi dhe 30 vëzhguesve afatshkurtër, sipas lidhjes nr.2 bashkëlidhur këtij vendimi.

Vendimi nr.219

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.12.04.2021*

**12.04.2021
Ora 13:56**

RENDI I DITËS

Projektvendimi “Një shtesë në Vendimin nr.115, datë 08.03.2021 “Për miratimin e gazetarëve të BIRN për vëzhgimin e zgjedhjeve për Kuvendin e Shqipërisë, të datës 25 Prill 2021”.

PJESËMARRJA :

- **KQZ**
1.Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve **Z.Illirjan Celibashi**
2.Stafi KQZ: **Y.Merkaj, M.Koja, V.Ballgjini, E.Allushi**
- **Parti Politike: PD, LSI**

Z. I. Celibashi: Vazhdojmë me pikën tjetër të rendit të ditës!

E keni parë dokumentacionin tek të gjithë kërkuesit dhe është në përputhje me kodin? Nuk ka asnjë problem në lidhje me dokumentacionin nga asnjë prej organizatave?

Z. Y. Merkaj: Jo, jo, janë të gjitha në rregull.

Z. I. Celibashi: Dakord, përfaqësuesit e partive politike? Nuk kanë ndonjë diskutim. Kemi një shtesë në Vendimin nr.115, datë 08.03.2021 “Për miratimin e gazetarëve të BIRN për vëzhgimin e zgjedhjeve për Kuvendin e Shqipërisë, të datës 25 Prill 2021”. Në këtë shtesë vendimi kemi akreditimin edhe të një gazetari shtesë, nga 115 që janë të miratuar tashmë si vëzhgues. Listës së gazetarëve të BIRN i shtohet edhe një gazetar tjetër për vëzhgimin e zgjedhjeve.

Vendimi nr.220

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.12.04.2021*

12.04.2021
Ora 13:56

RENDI I DITËS

Projektvendimi “Për një shtesë në Vendimin nr.98, datë 22.02.2021 “Për miratimin e vëzhguesve afatgjatë të Komitetit Shqiptar të Helsinkit për vëzhgimin e zgjedhjeve për Kuvendin e Shqipërisë, të datës 25 Prill 2021”.

PJESËMARRJA :

- **KQZ**
1.Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve **Z.Illirjan Celibashi**
2.Stafi KQZ: **Y.Merkaj, M.Koja, V.Ballgjini, E.Allushi**
- **Parti Politike: PD, LSI**


Z. I. Celibashi: Vazhdojmë me pikën tjetër të rendit të ditës!

E keni parë dokumentacionin tek të gjithë kërkuesit dhe është në përputhje me kodin? Nuk ka asnjë problem në lidhje me dokumentacionin nga asnjë prej organizatave?

Z. Y. Merkaj: Jo, jo, janë të gjitha në rregull.

Z. I. Celibashi: Dakord, përfaqësuesit e partive politike? Nuk kanë ndonjë diskutim. Kemi një shtesë në Vendimin nr.98, datë 22.02.2021 që lidhet me miratimin e vëzhguesve afatgjatë të Komitetit Shqiptar të Helsinkit për vëzhgimin e zgjedhjeve për Kuvendin e Shqipërisë, të datës 25 Prill 2021” ku shtohen dhe 8 vëzhgues të tjerë afatgjatë. Ky është për vëzhguesit afatgjatë, akti i mëparshëm ishte për vëzhguesit afatshkurtër. **Vendimi nr.221**

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.12.04.2021*

**12.04.2021
Ora 13:56**

RENDI I DITËS

*Projektvendimi “Për miratimin e vëzhguesve afatshkurtër dhe përkthyesve të
Ambasadës së Republikës Sllovae, të Ambasadës së Republikës Çeke, të
Ambasadës së Republikës së Maqedonisë së Veriut, të Ambasadës Austriake dhe
të Ambasadës Greke për vëzhgimin e zgjedhjeve për Kuvendin e Shqipërisë, të
datës 25 Prill 2021”.*

PJESËMARRJA :

• **KQZ**

1.Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve Z.Illirjan Celibashi

2.Stafi KQZ: Y.Merkaj, M.Koja, V.Ballgjini, E.Allushi

• **Parti Politike: PD, LSI**

Z. I. Celibashi: Vazhdojmë me pikën tjetër të rendit të ditës!

E keni parë dokumentacionin tek të gjithë kërkuesit dhe është në përputhje me kodin? Nuk ka asnjë problem në lidhje me dokumentacionin nga asnjë prej organizatave?

Z. Y. Merkaj: Jo, jo, janë të gjitha në rregull.

Z. I. Celibashi: Dakord, përfaqësuesit e partive politike? Nuk kanë ndonjë diskutim. Kemi miratimin e kërkesës së Ambasadës së Republikës Sllovae, për akreditimin e një vëzhguesi afatshkurtër dhe një përkthyesi.

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.12.04.2021*

Kemi miratimin e kërkesës së Ambasadës së Republikës Çeke, për akreditimin e tre vëzhguesve afatshkurtër dhe një përkthyesi.

Kemi miratimin e kërkesës së Ambasadës së Republikës së Maqedonisë së Veriut, për akreditimin e tre vëzhguesve afatshkurtër.

Kemi miratimin e kërkesës së Ambasadës Austriake për akreditimin e tre vëzhguesve afatshkurtër dhe gjashtë përkthyesve.

Kemi miratimin e kërkesës së Ambasadës Greke për akreditimin e gjashtëmbëdhjetë vëzhguesve afatshkurtër dhe tetë përkthyesve.

Këto janë të gjitha, por ndërkohë kemi dhe kërkesa të institucioneve dhe organizatave të tjera që kanë ardhur dhe janë në proces vlerësimi.

Çështje të tjera jashtë rendit ditës? Nuk kemi! Ju faleminderit, seanca mbyllet!

Vendimi nr.222

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*

